

VENDIM
Nr. 283, datë 21.5.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 912, DATË 22.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE
TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
OPERACIONIN “RSM” TË NATO-s, PRANË KOMANDËS SË BATALIONIT
SHUMËKOMBËSH, NË AFGANISTAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 912, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Në titull fjalët “... një toge ...” zëvendësohen me fjalën “... personelit ...”;
 - b) Në pikën 1, fjalët “... një toge ...” zëvendësohen me fjalën “... personelit ...” dhe numri “... 30 (tridhjetë)... ndryshohet dhe bëhet “... 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) ...”;
 - c) Në pikën 2, fjala “... togës ...” zëvendësohet me fjalën “... personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ...”;
 - ç) Në pikën 3, fjala “... përfaqësuesit ...” zëvendësohet me fjalën “... kontingjentit ...” dhe fjala “... përfaqësues ...” zëvendësohet me fjalën “... kontingjent ...”;
 - d) Në pikën 4, fjalët “... kësaj toge ...” zëvendësohen me fjalët “... personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ...”.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama